




REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep.	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.
<u>7D/DPK</u>	<u>01-1260/15</u>
Nr. ftaq Broj stranica Nr. pages	Data Datum Date
<u>02</u>	<u>05.05.2015</u>
PRISTINE	



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 24 paragrafi 11 dhe 12 të Rregullorës së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 30.04.2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-02-509-15 për z. Abit Kastrati – Këshilltar Komunal në Kuvendin e Prishtinës, për shkak se nuk ka elemente të mjaftueshme që dëshmojnë gjendjen e konfliktit të interesit gjatë procesit të diskutimeve dhe votimit për Anëtarët e komisionit të Aksionareve për Ndërmarrjet Publike të Komunës së Prishtinës, po ashtu nuk ka elemente të mjaftueshme që dëshmojnë konfliktin e interesit në lidhjen e dy kontratave nga z. Kastrati me Kompaninë Raionale të Mbeturinave -Pastrimi

II. Zyrtari i lartë, z. Kastrati, pas rekomandimit të AKK-së, ka bartur drejtimin e ndërmarrjes dhe ka shmangur pa pajtueshmërinë në ushtrimin e funksionit publik, ndërsa është i obliguar që në rast të paraqitjes eventuale të ndonjë situatë me konflikt “rast për rast” të interesit, të bëjë deklarinimin paraprak të interesave private (konform neni 13, paragrafi 1,2,3).

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur me kërkesën e palëve denoncuese nën dyshimin e bazuar për Konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, me nr. AKK-03-02-509-15, për Zyrtarin e lartë, z. Abit Kastrati – Këshilltar Komunal në Kuvendin e Prishtinës, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Zyrtari i lartë, z.Kastrati fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit (AKK), pas të cilës ajo është kontaktuar nga zyrtarët e Agjencisë kundër Korrupsionit, me ç'rast, është njoftuar me pretendimet nga pala e tretë për situatë të dyshuar për konfliktin e interesit, duke qenë se z.Kastrati në cilësinë e Këshilltarit Komunal në KK të Prishtinës në Seancën e jashtëzakonshme të datës 14 janar 2015 dhe në Seancën e rregulltë të Kuvendit të datës 05 shkurt 2015, gjatë procesit të diskutimeve dhe votimit, pretendohet se ka pasur Konflikt interesi me Vendimet e marra në KK të Prishtinës.

Në takim me z.Kastrati dhe në bazë të Ekstraktit të Procesverbalit nga Mbledhja e Kuvendit të Prishtinës, mbajtur me 05.02.2015 (DPK/DPKI-03-02-815/15) kemi vërtetuar se në atë Seancë së pari me Vendim që ka dal nga votimi në Kuvend, janë shkarkuar Anëtarët e Komisioneve të Aksionarëve. Ndërsa, po ashtu pas votimit, pastaj është miratuar Vendimi për caktimin e Anëtarëve të Komisioneve të Aksionareve të Ndërmarrjeve publike të Komunës së Prishtinës, në të cilët z.Kastrati është propozuar te NP."Prishtina-Parking".

Fakti se z.Kastrati ka qenë pjesë e këtij procesi nuk është konflikt interesi sepse askund nuk ka dispozita ligjore që ja ndalojnë këtë.

Nëse eventualisht ndodhë që gjatë ushtrimit të këtij funksioni publik z.Kastrati të gjendet para ndonjë situatë me konflikt "rast për rast" të interesit, atëherë ai është i obliguar që të vepron konform dispozitave ligjore që janë të theksuara në nenin 13 paragrafi 1,2,3 të Ligjit për Parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Sa i përket informatës se deponuar nga denoncuesi i rastit që ka të bëjë me lidhjen e dy kontratave në mes të z. Abit Kastrati si menaxher i Kompania N.T.P "AJORONI COM" dhe Kompanisë Rajonale "Pastrimi", kjo situatë është analizuar dhe nuk kemi gjetur elemente të mjaftueshme që të cilësohet si mos pajtueshmëri në ushtrim të funksionit publik të paraparë sipas nenit (15.5 LPKI), dhe që do mund të vepronim sipas nenit 15.6, të Ligjit Nr.04/L-051), pasi që zyrtari i lartë z. Kastrati nuk ka qenë në pozitë vendimmarrëse në Kompaninë - KRM-Pastrimi e cila ka vendosur lidhur me këto kontrata.

Agjencia Kundër Korrupsionit gjatë trajtimit të këtij rastit në kuadër të kompetencave të veta, ka konstatuar një situatë tjetër që quhet Papajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik të paraparë sipas nenit 15.1 të Ligjit Nr.04/L-051, Për këtë AKK-ë e ka njoftuar z.Kastrati dhe nga aji është kërkuar shmangia nga kjo situatë.

Fjala është për të qenurit person i autorizuar i biznesit privat dhe njëkohësisht zyrtar i lartë – Këshilltar në Asamblenë komunale në Prishtinë.

Nga zyrtari i lart z. Kastrati, është kërkuar që në afat prej 7 dite të shmangë situatën e papajtueshme në ushtrim të funksionit publik e që mund të sjell konflikt faktik të interesit. Ushtrimi i njëkohësisht i funksionit të zyrtarit të lartë publik si Këshilltar në Asamblenë komunale të Prishtinës dhe menaxher në biznesin privat është në kundërshtime me (Neni 15 paragrafi 1, i Ligjit Nr.04/L-051), andaj është kërkuar të heq dorë nga të qenurit person i autorizuar në biznesin privat: NTP "Ajroni Com", ose duhet heq dorë nga ushtrimi i funksionit publik si Këshilltar komunal në KK të Prishtinës.

Ndërkohë, ztr.Kastrati në Agjencinë kundër Korrupsionit ka sjell dokumentin zyrtar (DPK-Dpki-03-02-1228) nga Agjencioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK) në të cilin shihet se z. Kastrati ka hequr dorë nga funksioni i personit të autorizuar në biznesin e përmendur më lartë duke emëruar në këtë pozitë një person të besuar, ashtu siç parashihet në Ligjin për Parandalimin e konfliktit të interesit.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari ndihmës)

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

/ Hasan Preteni

